



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BORXHIT PUBLIK DHE BASHKËRENDIMIT TË
NDIHMËS SË HUAJ
DREJTORIA E HUAMARRJES

20582

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më 7/11/2022

UDHËZIM

Nr.30, Datë7.11.2022

**“PËR MIRATIMIN E METODOLOGjisË PËR VLERËSIMIN E
BANKAVE ZHVILLUESE TË TREGUT”**

Tiranë, 2022

PËRMBAJTJA

I.	TË PËRGJITHSHME.....	3
II.	FREKUENCA E VLERËSIMIT	4
III.	FUSHAT E VLERËSIMIT	4
IV.	TREGUESIT E VLERËSIMIT	5
4.1.	Aktiviteti në treg primar.....	5
4.2.	Aktiviteti në treg sekondar.....	6
4.3.	Komunikimi dhe analiza.....	7
V.	NUMRI I BANKAVE PJESËMARRËSE	7
VI.	ZBATIMI DHE HYRJA NË FUQI.....	8

Në mbështetje të marrëveshjeve të nënshkruara midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe bankave Zhvilluese të Tregut më 23 janar 2019, përditësuar më 7 mars 2019 në vijim të vendimmarres së Komitetit të Zhvilluesve të Tregut, Ministri i Financave dhe Ekonomisë udhëzon si më poshtë:

I. TË PËRGJITHSHME

Detyrimet kryesore të Zhvilluesve të Tregut, sipas marrëveshjes së nënshkruar me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE), janë:

1. Pranon dhe paraqet kërkesat e klientëve në ankandet e titujve referencë;
2. Paraqet kërkesa, në emër të vet apo për llogari të klientëve, në emetimet e reja ose në rihapjet e titujve referencë;
3. Ble të paktën 5% të titujve referencë të emetuar;
4. Raporton shifrat e qarkullimit në tregun sekondar për obligacionet referencë, sipas formatit të raportimit të rënë dakord me MFE;
5. Promovon në mënyrë aktive një treg sekondar funksional;
6. Kontribuon në krijimin e likuiditetit të obligacioneve referencë nëpërmjet kuotimit të çmimeve;
7. Analizon tregun e letrave me vlerë të qeverisë dhe informon në mënyrë të vazhdueshme MFE-në për kushtet e tregut, si dhe rekomandon masa që mund të përmirësojnë likuiditetin e tregut.

Në përgjithësi, pritshmëritë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nga Market Makers janë:

- (I) Marrin pjesë rregullisht në ankandet e letrave me vlerë të qeverisë në tregun primar;
- (II) Kontribuojnë në zhvillimin e tregut sekondar;
- (III) Kanë kapacitet operacional të përshtatshëm për statusin e Zhvilluesit të Tregut;
- (IV) Komunikojnë dhe shkëmbejnë informacion rregullisht me Ministrinë.

Bazuar në këto pritshmëri, Ministria e Financave dhe Ekonomisë propozon metodologjinë e mëposhtme për vlerësimin e aktivitetit tregtar nga bankat pjesëmarrëse.

Me zhvillimin e tregut dhe zgjerimin e aktivitetit të tregut sekondar, metodologja mund të rishikohet duke përfshirë tregues shtesë, ose duke përpunuar më tej treguesit e propozuar.

II. FREKUENCA E VLERËSIMIT

- Vlerësimi do të zhvillohet **çdo 6 muaj** (2 herë në vit) dhe do të ndahet me nivelin e lartë drejtues të çdo banke brenda fundit të muajit pasues të periudhës së vlerësimit (p.sh. fundi i korrikut/janarit).
- Rezultatet do të diskutohen veçmas me secilën bankë, por edhe në mbledhjen e përbashkët të Komitetit të Zhvilluesve të Tregut, ku do të shpallen dy bankat me performancë më të mirë.

III. FUSHAT E VLERËSIMIT

Metodologjia e zhvilluar më poshtë bazohet në tre shtylla kryesore, ku secila prej tyre ka një peshë të ndryshme ¹:

- Aktiviteti në treg primar (50%)
- Aktiviteti në treg sekondar (40%)
- Komunikimi dhe analiza (10%)

Për çdo kategori është zgjedhur një grup treguesish sasiorë dhe cilësorë. Duke marrë parasysh rëndësinë e ndryshme, secilit tregues i caktohet gjithashtu një peshë, **nga 1 në 4, me vlera më të larta për treguesit më të rëndësishëm**.

Numri /vlera e caktuar për secilin tregues mund të jetë e dy formave:

¹ Bazuar në kushtet e tregut dhe prioritetet e politikave, Ministria rezervon të drejtën për të rishikuar këto pesha.

1. Bazuar në një renditje të institucioneve (1-5 pikë): 5 pikë (një numër i barabartë me numrin e bankave pjesëmarrëse) për institucionin me renditje më të lartë dhe 1 pikë për institucionin me renditjen më të ulët;
2. Bazuar në performancë (1-5 pikë): Nga 1 deri në 5 pikë, me një numër më të lartë për një performancë më të mirë;

Si përfundim, institucionet do të renditen në bazë të numrit total të ponderuar të pikëve që u janë caktuar.

IV. TREGUESIT E VLERËSIMIT

4.1. Aktiviteti në treg primar

Pritshmëria: Zhvilluesit e Tregut duhet të marrin pjesë rregullisht në ankandet e letrave me vlerë të qeverisë, me oferta çmimesh që pasqyrojnë kushtet e tregut dhe në përputhje me kuotën e tregut primar të rënë dakord me Ministrinë.

Treguesit :

1. Ble të paktën 5% të instrumenteve referencë 3 dhe 5-vjeçare të emetuara plotësisht² (*nëse ky kusht nuk plotësohet në dy ose më shumë raste, Ministria ka të drejtë të përjashtojë bankën pjesëmarrëse nga programi*);
2. Përqindja e kërkeseve të pranuara për obligacionet referencë 5V mbi totalin e emetuar gjatë periudhës së vlerësuar (*1-5 pikë sipas pozicionit në renditje / pesha: 4*)
3. Përqindja e kërkeseve të pranuara për obligacionet referencë 3V mbi totalin e emetuar gjatë periudhës së vlerësuar (*1-5 pikë sipas pozicionit në renditje / pesha: 3*)

² Ky indikator nuk përfshihet në renditje. Llogaritja bëhet mbi shumën totale të emetuar (emetim i ri + rihapje) për një ISIN të caktuar. Verifikimi nëse zhvilluesit e tregut e kanë respektuar këtë kriter do bëhet në fund të ciklit të vlerësimit vetëm për ISIN-et emetimet e të cilëve janë përmbyllur.

4. Përqindja e kërkesave të pranuara mbi totalin e kërkesave të paraqitura (*1-5 pikë sipas pozicionit në renditje / pesha: 3*)
5. Diferenca midis rezultatit të përgjithshëm të tregut primar për periudhën e vlerësuar me atë të periudhës së mëparshme të vlerësimit (*1-5 pikë sipas pozicionit në renditje / pesha: 2*)

4.2. Aktiviteti në treg sekondar

Pritshmëria : Krijuesit e tregut duhet të kontribuojnë në zbulimin e çmimeve, të rrisin likuiditetin dhe qarkullimin e tregut dhe të inkurajojnë një bazë më të gjerë investitorësh.

Treguesit :

1. Përqindja e transaksioneve në tregun sekondar mbi totalin e vëllimit të tregtisë në tregun sekondar për instrumentin 5V gjatë periudhës së vlerësuar (*1-5 pikë sipas pozicionit në renditje / pesha: 4*)
2. Përqindja e transaksioneve në tregun sekondar mbi totalin e vëllimit të tregtisë në tregun sekondar për instrumentin 3V gjatë periudhës së vlerësuar (*1-5 pikë sipas pozicionit në renditje / pesha: 3*)
3. Performanca e detyrimit të kuotimit e matur si një mesatare e diferençës ditore të çmimit shit-blerës (bid-ask spread) gjatë periudhës së vlerësuar (*1-5 pikë sipas pozicionit në renditje / pesha: 3*)
4. Kuotimet e fiksit dhe devijimet nga yield-et e ofruara në tregun primar: diferenca ndërmjet mesatares së ponderuar të yield-it për ofertat konkurruese me fiksin e një dite më parë për të njëjtin maturim (*1-5 pikë sipas pozicionit në renditje / pesha: 3*)
5. Numri i palëve në transaksionet e tregut dytësor (*1-5 pikë sipas performancës / pesha: 1*)
6. Diferenca midis rezultatit të përgjithshëm të tregut sekondar për periudhën e vlerësuar me atë të periudhës së mëparshme të vlerësimit (*1-5 pikë sipas pozicionit në renditje / pesha: 2*)

4.3. Komunikimi dhe analiza

Pritshmëria: Zhvilluesit e Tregut duhet të komunikojnë dhe të shkëmbejnë informacione rregullisht me Ministrinë, si dhe të veprojnë si urë informacioni për palët e tjera të interesuara për të investuar në letrat me vlerë të qeverisë.

Treguesit :

- Përpikëri dhe korrektësi në raportim (*1-5 pikë sipas performancës, pesha: 3*)
- Lehtësia e gjetjes së informacionit për letrat me vlerë të qeverisë në faqen e internetit të Zhvilluesve të Tregut ose në vendndodhjet fizike të bankave (*1-5 pikë sipas performancës, pesha: 3*)
- Analiza e dorëzuar në MFE mbi tregun e letrave me vlerë të qeverisë, duke përfshirë rekomandimet se si të përmirësohet likuiditeti i tregut (përafërsisht 2 deri në 5 faqe, në fund të çdo cikli vlerësimi) (*1-5 pikë sipas performancës, pesha: 3*)

V. NUMRI I BANKAVE PJESËMARRËSE

Në rast se një bankë vendase shpreh interes për t'u bërë pjesë e programit Market Maker, do të merren parasysh dy opzionet e mëposhtme:

- a) Zgjerimi i numrit të bankave pjesëmarrëse


Ky opzioni do të merret parasysh nëse:

- Të gjitha bankat pjesëmarrëse kanë pasur një performancë të kënaqshme;
- Ministria vlerëson se zgjerimi i numrit të bankave pjesëmarrëse nuk krijon efekte kundërproduktive në aktivitetin e tregut primar dhe sekondar.

- b) Zëvendësimi i Zhvilluesve të Tregut ekzistues me banka të reja bazuar në performancën e kaluar

Ky opzioni do të merret parasysh nëse:

- Një (ose disa) nga bankat pjesëmarrëse ka pasur një performancë të dobët në kohë.



Në këtë rast, Ministria do t'i komunikojë me shkrim menaxhmentit të lartë të bankës së përjashtuar arsyetimin e këtij vendimi, duke përfshirë edhe krahasimin me zhvilluesit e tjerë të tregut.

Vlerësimi i një banke të re pjesëmarrëse në program do të nisë nga momenti i pranimit, por përfshirja në renditje do të nisë vetëm nga momenti që banka ka plotësuar në cikël të plotë 6 muajor (janar-qershor ose korrik-dhjetor) në program. Çdo bankë e sapo pranuar ka të drejtë të mbetet pjesë e programit për të paktën dy cikle të plota vlerësimi (pra 1 vit).

VI. ZBATIMI DHE HYRJA NË FUQI

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Sektori i Huamarrjes në Tregun e Brendshëm në Drejtorinë e Huamarrjes në MFE.

Ky udhëzim hyn në fuqi më 1 janar 2023.



7